

**AKT - THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGTARE  
“ELDA PETROLEUM ALBANIA”SH.P.K.  
(ORTAK I VETËM)**

Sot më datën 15.12.1999,

Shoqëria “GLOBAL PETROLEUM ALBANIA”SH.A., person juridik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.21689 datë 20/07/1999 me Vendimin Nr.3 datë 02.12.1999 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve dhe në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për rregjistrin tregtar”, Ligjit Nr.7512 datë 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, veprimtarisë private dhe privatizimit” si dhe Ligjit Nr.8450 datë “Per përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” dhe VKM Nr.129 datë 18.03.1999 ka vendosur të krijojë një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sipas kushteve e normave të parashikuara në Statutin e shoqërisë bashkëngjitur dhe në këtë Akt - Themelimi si më poshtë vijon:

*Neni 1*

Të themelojë Shoqërinë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar me Ortak të Vetëm të emërtuar: “ELDA PETROLEUM ALBANIA” Sh.P.K.

*Neni 2*

Selia e Shoqërisë do të jetë e saj në Rr. “4 Shkurti”, Pall.7, Shk.1, Ap.15, Tiranë.

Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

*Neni 3*

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

Shoqëria mund të shpërmdahet edhe para këtij afati në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm.

*Neni 4*

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë Tregtare “ELDA PETROLEUM ALBANIA” Sh.p.k do të jetë:

1. Tregtimin me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj, administrimin dhe shfrytëzimin e pikave të shitjes së karburanteve me pakicë brenda territorit shqiptar.
2. Hapjen në pikat e karburanteve të dyqaneve të vogla (Mini – Shop) për tregtimin e

aksesuarëve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit.

3. Importimin dhe tregtimin e vajrave lubrifikante brenda dhe jashtë territorit shqiptar.

4. Importimin në Shqipëri i të gjithë paisjes mekanike si dhe i paisjes së reklamave (paisje projekcioni) që kërkohen për ndërtimin e pikave të karburantit.

5. Importimi i të gjitha pjesëve të këmbimit që kërkohen për mirëmbajtjen e paisjeve që përmenden në paragrafin 4.

6. Importimi i të gjitha pjesëve të këmbimit dhe të gomave që kërkohen për mirëmbajtjen e autoboteve dhe të autoveturave të shoqërisë.

7. Ndërtimi i objekteve të pikave të karburanteve si dhe i njësive hoteliere.

8. Importimi i të gjithë paisjes që kërkohet sa sipër sipas paragrafit 7.

#### *Neni 5*

**Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 lekë.**

Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë me vlerë 1,000 lekë secila, të renditura nga numri 1 deri në 100 krejtësisht të shlyeshme. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen 100% nga **Ortaku i Vetëm**, shoqëria "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA"SH.A.

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakut.

#### *Neni 6*

Kapitali themeltar i Shoqërisë, përfaqëson kapitalin e derdhur nga **Ortaku i Vetëm**, i nevojshëm për veprimtarinë e Shoqërisë. Sipas kërkesës së ligjit, administratorët **Vasileios ARMAOS** dhe **Dimitrios GAVRIIL** kanë të drejtë të çelin një llogari bankare në një nga Bankat që janë në territorin e Shqipërisë, në të cilën do të depozitohet kapitali themeltar i shoqërisë në formim.

Kapitali Themeltar mund të përbëhet edhe nga kontribute në natyrë. Në këtë rast vlerësimi i kontributeve në natyrë do të bëhet sipas N. 42 të Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992.

Në librin e llogarisë që do të krijohet në shoqërinë tregtare do të shënohet edhe kapitali i derdhur nga **Ortaku i Vetëm**.

Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

#### *Neni 7*

Shoqëria Tregtare në marrëdhëniet me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e shoqërisë, fondet e saja dhe Ortaku përgjigjet për detyrimet e kësaj Shoqërie vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

#### *Neni 8*

Shoqëria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë ose për shkaqe të tjera të përcaktuara në Statut.

Fitimi neto ndahet sipas pjesëve të kontributit në kapitalin themeltar.

### *Neni 9*

**Organet drejtuese të shoqërisë janë:**

- **Ortaku i Vetëm**
- **Administratorët.**

Administratorët emërohen e shkarkohen prej Asamblesë së Ortakëve.

**Administratorë të shoqërisë** deri në shkarkimin e tyre nga Asambleja e Ortakëve do të jenë z. **Dimitrios GAVRIIL** dhe z. **Vasileios ARMAOS**.

Modalitetet për përbërjen dhe funksionimin e organeve të mësipërme përcaktohen nga statuti i Shoqërisë si dhe nga Ligji "Për Shoqëritë Tregtare".

### *Neni 10*

Ortaku është i detyruar të ruajë sekretin e dokumentacionit, informacionit, njohjeve dhe të eksperiencës së këmbyer e të realizuar brenda Shoqërisë dhe të marrë të gjitha masat për të evituar përhapjen e tyre qoftë dhe në mënyrë të pjesëshme.

Ortaku është përgjegjës për pasojat e dëmshme, të shkeljeve ndaj ligjit për Shoqëritë Tregtare.

### *Neni 11*

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin në marrëdhëniet me të tretët, gjatë ekzistencës së Shoqërisë do të zgjidhen nga Gjykata e Arbitrazhit. Kur të dyja palët janë me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin shqiptar. Kur njëra nga palët është e huaj, gjykata e arbitrazhit vendos sipas rregullave të së drejtës të zgjedhur nga palët dhe në mungesë të kësaj zgjedhjeje, sipas rregullave me të cilat është më e lidhur.

### *Neni 12*

Më të detajuara dispozitat për Shoqërinë Tregtare "ELDA PETROLEUM ALBANIA" Sh.P.K janë përcaktuar dhe përmbahen në Statutin e saj.


### *Neni 13*

Kjo kontratë formulohet në katër kopje, nga të cilat njëra depozitohet në Zyrën e Noterisë Tiranë, njëra depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në Zyrën e Tatimeve Tiranë dhe kopja e katërt mbahet në dokumentat e Shoqërisë.

Kontrata është e vlefshme që nga momenti i nënshkrimit të saj nga ortaku i vetëm.

**ORTAKU I VETËM**  
**"GLOBAL PETROLEUM ALBANIA"SH.A.**

**Vasileios ARMAOS**  
**Drejtori i Përgjithshëm**





**STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**“ELDA PETROLEUM ALBANIA” SH.P.K.**

Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ELDA PETROLEUM ALBANIA” Sh.P.K, është krijuar sipas kontratës për themelimin e saj nga **ORTAKU i VETËM:**

Shoqëria “GLOBAL PETROLEUM ALBANIA”SH.A. krijuar si person juridik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.21689 datë 20/07/1999 dhe e përfaqësuar këtu në bazë të Vendimit Nr.3 datë 02.12.1999 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve nga z. Vasileios ARMAOS, i biri i Christos, lindur më 06/04/1949 në Athinë dhe banues në Tiranë, Rr. “4 Shkurti”, Pall.7, Shk.1, Ap.15, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr.150327 datë 06.04.1987 dhe pasaportës Nr.K 393504, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Për të bërë të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj Shoqërie në përputhje me Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993 “Për rregjistrin tregtar” dhe Ligjit Nr.8450 datë “Per përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” dhe VKM Nr.129 datë 18.03.1999, është përpiluar Statuti me përmbajtje si më poshtë:

**KREU I PARË**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

(forma, emërtimi, objekti, selia, kohëzgjatja)

*Neni 1*

Ortaku i Vetëm pjesëmarrës në Kontratën e Themelimit ka krijuar një Shoqëri Tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria Tregtare e fiton zotësinë për të vepruar si person juridik me rregjistrimin e saj në **Gjykatën e Rrethit Tiranë** si dhe rregjistrimin e saj në

## **Rregjistrin Tregtar.**

Shoqëria Tregtare do të nxjerrë të gjitha liçensat e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.

### *Neni 2*

- Si më sipër, Shoqëria Tregtare emërtohet “**ELDA PETROLEUM ALBANIA**” Sh.P.K dhe ka si objekt të saj:
  1. Tregtimin me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj, administrimin dhe shfrytëzimin e pikave të shitjes së karburanteve me pakicë brenda territorit shqiptar.
  2. Hapjen në pikat e karburanteve të dyqaneve të vogla (Mini – Shop) për tregtimin e aksesuarëve për të gjitha llojet e mjeteve të transportit.
  3. Importimin dhe tregtimin e vajrave lubrifikante brenda dhe jashtë territorit shqiptar.
  4. Importimin në Shqipëri i të gjithë paisjes mekanike si dhe i paisjes së reklamave (paisje projeksioni) që kërkohen për ndërtimin e pikave të karburantit.
  5. Importimi i të gjitha pjesëve të këmbimit që kërkohen për mirëmbajtjen e paisjeve që përmenden në paragrafin 4.
  6. Importimi i të gjitha pjesëve të këmbimit dhe të gomave që kërkohen për mirëmbajtjen e autoboteve dhe të autoveturave të shoqërisë.
  7. Ndërtimi i objekteve të pikave të karburanteve si dhe i njësive hoteliere.
  8. Importimi i të gjithë paisjes që kërkohet sa sipër sipas paragrafit 7.

Për përmbushjen e këtij objekti shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera me objekt të njëjtë ose të përafërt.

Shoqëria në bazë të legjislacionit shqiptar ka të drejtë të hapi filiale, degë, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

- **Selia e shoqërisë tregtare** ndodhet në Tiranë në adresën Rruga “ 4 Shkurti”, Pall.7, Shk.1, Ap.15 - Tiranë, Shqipëri.
- **Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare** është parashikuar për një periudhë 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjeçare. Ky afat mund të zgjatet ose të



zvogëlohet sipas propozimeve të bëra nga **Ortaku i Vetëm** dhe pasi të vendoset nga ai.

## **KREU II**

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

#### ***Neni 3***

**Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare** është 100 000 lekë. Ky kapital është i ndarë në 100 pjesë me vlerë 1,000 lekë secila, të renditura nga numri 1 deri në 100 krejtësisht të shlyeshme. Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen 100% nga Ortaku i Vetëm, shoqëria **“GLOBAL PETROLEUM ALBANIA”SH.A.**

Pjesët e Kapitalit Themeltar përfaqësojnë kontribute në para dhe janë shlyer plotësisht prej ortakut.

Pjesët e Kapitalit Themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyrë, por asnjëherë kontribute në shërbime.

Kur pjesët e kapitalit përfaqësojnë kontribute në natyrë vlerësimi i tyre bëhet nga një ekspert për kontributet nëpërmjet një raporti që i bashkangjitet statutit. Eksperti caktohet nga ortakut.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.

### **ZMADHIMI I KAPITALIT**

#### ***Neni 4***

Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të **Ortakut të Vetëm**.

Zmadhimi i kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontribute në para, bëhet sipas paragrafit të fundit të nenit 40 të L.Nr.7638/19.11.1992.

Zmadhimi i kapitalit plotësisht ose pjesërisht me anë të kontributeve në natyrë, bëhet sipas kërkesave të nenit 42, paragrafi i parë i L.Nr.7638/19.11.1992. Megjithatë eksperti i autorizuar për kontributet emërohet me vendim të gjykatës sipas kërkesës së administratorit.

## ZVOGËLIMI I KAPITALIT

### Neni 5

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga **Ortaku i Vetëm**, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

### Neni 6

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, vetëm me vendimin e Ortakut të Vetëm.

## KREU I DYTË

### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

#### Neni 7

Organi vendimor i Shoqërisë është **Ortaku i Vetëm**.

Ortaku i vetëm mund ti delegojë kompetencat e tij. Vendimet e tij të marra në vend të asamblesë evidentohen në një regjistër.

#### Neni 8

**Ortaku i Vetëm** vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për shtimin dhe pakësimin e kapitalit themeltar, për emërimet e shkarkime të administratorit, për emërimin e ekspertëve kontabël, për pushimin, për hapjen e degëve, përfaqësive dhe filialeve në rrethet e tjera, për transformimin e shoqërisë në një formë tjetër, për zgjatjen e afatit etj.

Sipas rëndësisë së vendimeve mbledhjet e asamblesë mund të jenë të zakonshme ose të jashtëzakonshme:

- **Ortaku i Vetëm** vendos për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i



raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes së fitimit etj. si dhe për çështje të tilla si ndryshimi i statutit, rritja ose zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së Shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërrimi i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një shoqëri të formave të tjera.

#### *Neni 9*

**Ortaku i Vetëm** mbledhjet e zakonshme i bën çdo vit brenda katër muajve nga mbyllja e veprimtarisë financiare të Shoqërisë.

#### *Neni 10*

Administratorët emërohen e shkarkohen nga **Ortaku i Vetëm** me vendim të tij. Administratorët mund të zgjidhen edhe jashtë bashkësisë së ortakëve.

#### *Neni 11*

Administratorë të shoqërisë deri në shkarkimin e tyre nga **Ortaku i Vetëm** do të jenë **z. Dimitrios Gavril** dhe **z. Vasileios Armaos**.

Administratorët e përfaqësojnë shoqërinë dhe e angazhojnë atë duke nënshkruar gjithmonë së bashku.

#### *Neni 12*

Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë me përjashtim të çështjeve që vijnë, për të cilat kërkohet vendim i **Ortakut të Vetëm**:

- a) i.** Blerje ose shitje e mallrave që tregton shoqëria (naftës, vajrave lubrifikante etj), vlera e të cilave e kapërcen shumë prej **150,000USD** (njëqind e pesëdhjetë mijë dollarë amerikanë).
- ii.** Blerje ose shitje e pronave të lujtshme, përveç sa përmendet më sipër, vlera e të cilave e kapërcen shumë prej **70,000USD** (shtatëdhjetë mijë dollarë amerikanë).
- iii.** Blerja ose shitja e pronave të paluajtshme.



iv. Pjesmarrje në tendera duke dhënë oferta angazhuuese, vlera e të cilave e kapërcen shumën prej **250,000USD** (njëzet e pesë mijë dollarë amerikanë).

- b) i.** Lidhjen e kontratave të qirasë për objekte në shuma që i kapërcen **20,000USD** (njëzet mijë dollarë amerikanë).
- ii.** Lidhjen e kontratave të qirasë për pasuri të luajtshme që e kapërcejnë shumën prej **20.000USD** (njëzet mijë dollare amerikane).
- c)** lidhjen e kontratave të huasë ose të dhënies së garancisë, ose dorëzarisë për të tretët pamvaresisht nga shuma.
- d)** kërkesën për nxjerrjen e kartës së garancisë për shoqërinë ose të tretë pamvaresisht nga shuma kur shuma.
- e)** marrjen në punë të kuadrove të larta për administratën.
- f)** caktimin e pagës për pagimin e shtesës për kuadrot e larta drejtuese.
- g)** transaksione ose kontrata të të gjitha llojeve me një aksioner ose administrator ose menaxher ose me ndonjë të afërm të të gjithë personave të sipërpërmendur deri në shkallën e tretë ose shoqëri me aktivitet të njëjtë të cilat janë të lidhura me aksionerët ose administratorët ose menaxherët ose me ndonjë të afërm të tyre deri në shkallën e tretë. Si shoqëri të njëjta të ortakut ose të administratorit nënkuptohen të gjithë personat që kontrollojnë, kontrollohen ose janë vënë nën kontroll të përbashkët me ndonjë ortak ose administrator dhe si kontroll nënkuptohet përfitimi i pushtetit direkt ose indirekt të drejtimit dhe udhëheqjes së një personi, ose me pronësinë e vlerave të paluajtshme që i japin të drejtë vote, ose me marrëveshje të veçantë, ose në çfarëdo mënyre tjetër. Personi këtu caktohet si person, shoqëri me një ortak, shoqëri anonime, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, një grup personash, një bashkëpunim, dhënie me mirëbesim, një organizatë pa personalitet juridik dhe një person juridik i së drejtës publike ose ndonjë sektor, autoritet i pavarur administrativ ose organizatë politike të tij.
- h)** miratimin ose ndryshimin e Plan-Biznesit dhe buxhetit vjetor.
- i)** caktimin e këshilltarëve ekonomikë dhe juridikë për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me shoqërinë.
- k)** krijimi ose pjesmarrja në shoqëri të tjera të çdo forme juridike, përfitimi i aksioneve, të elementëve pasurorë ose të elementëve të një shoqërie të një personi tjetër juridik me çfarëdo transaksioni.

**l)** miratimin e bashkëveprimeve afarist, pjesmarrjen e shoqërisë në investime të reja, marrjen përsipër të veprimtarive afariste që i shmangen kursit të zakonshëm të veprimtarive të shoqërisë.

**m)** vendimet që sipas ligjit i përkasin Asamblesë së Ortakëve.

Administratorët kanë të drejtë që kompetencat e tyre t'ia delegojnë personave të tretë me Prokurë të Posaçme ku do të përcaktohen shprehimisht të drejtat e deleguara vetëm me miratim të Ortakut të Vetëm.

### *Neni 13*

Klauzolat e statutit që kufizojnë kompetencat e administratorëve duhet të respektohen nga të tretët.

### *Neni 14*

Administratorëve nuk u lejohet të kontraktojnë në çfardo lloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj për paradhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Kjo masë është e vlefshme edhe për përfaqësuesit ligjorë të ortakëve që janë persona juridikë, si dhe bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

### *Neni 15*

Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

### *Neni 16*

Administratorët shkarkohen në çdo moment me vendim të **Ortakut të Vetëm** si dhe nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesën e ortakut.

### *Neni 17*

Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore hartohen nga administratori. **Ortaku i Vetëm** miraton llogaritë nëse është e nevojshme pas



raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar, brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment dokumentat e sipërpërmendura, për 3 vitet e fundit financiarë. Ai mund të ndihmohet nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

#### *Neni 18*

Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për çdo vit financiar me mundësi rizgjedhje. Ata caktohen nga mbledhja e **Ortakut të Vetëm**.

#### *Neni 19*

Për punonjësit që do të punësohen në Shoqërinë Tregtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin për një afat jo më shumë se një periudhë 1 vjeçare.

Paga e punës nuk është e kufizuar por ajo nuk mund të jetë më e ulët se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të Qeverisë.

### **KREU I TRETË**

#### **MARRËDHËNIET EKONOMIKO FINANCIARE**

#### *Neni 20*

Viti financiar fillon më datën 1 Janar dhe mbaron më datën 31 Dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga financieri i Shoqërisë, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### *Neni 21*

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimit,

**Ortaku i Vetëm**, përcakton pjesën që i takon mbi fitimin, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm (jo më pak se 1/20 e fitimit të çdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën e 1/10 të kapitalit themeltar) si dhe të jenë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### *Neni 22*

Llogaritë ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe dhe në atë greke, në lekë ose në valutë të huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin që detyrimisht do të pasqyrohen në bilancet e përpiluara nga financieri i Shoqërisë i cili mban përgjegjësi ligjore për punën e tij.

#### *Neni 23*

Shoqëria Tregtare me qëllim që ta bëjë sa më të lehtë dhe më të shpejtë pagesat me të tretët do të hapë llogari bankare në Bankat që janë të njohura nga Shteti Shqiptar vendase ose të huaja.

### **KAPITULLI I KATËRT**

#### **ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI**

#### *Neni 24*

Me mbarimin e afatit të përcaktuar në kontratën e themelimit zgjatja e tij bëhet vetëm me vendimin e **Ortakut të Vetëm**.

Ajo priset kur mbaron afati i përcaktuar dhe **Ortaku i Vetëm** nuk ka rënë dakort që të bëjë ripërtëritjen e këtij afati, në rast falimentimi dhe para afatit.

Shoqëria mund të shndërrohet në një nga format e përcaktuara nga ligji dhe në formën e kërkuar nga ligji.

#### *Neni 25*

Shoqëria Tregtare hyn në procesin e likuidimit që në momentin e vendosjes për



prishjen e saj. Për fillimin e këtij procesi **Ortaku i Vetëm** emëron likujdator të cilët paraqesin raportin e likujdimit, gjendjen e aktivitetit të pasivitetit të Shoqërisë, mbi mënyrën e ndjekjes së operacionit të likujdimit dhe afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, **Ortaku i Vetëm**, vendos mbi bilancin përfundimtar, mbi aktin dhe rregullsinë e likujdimit, mbi mbylljen e procesit të likujdimit të Shoqërisë.

#### *Neni 26*

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin në marrëdhëniet me të tretët, gjatë ekzistencës së Shoqërisë do të zgjidhen nga Gjykata e Arbitrazhit. Kur të dyja palët janë me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin shqiptar. Kur njëra nga palët është e huaj, gjykata e arbitrazhit vendos sipas rregullave të së drejtës të zgjedhur nga palët dhe në mungesë të kësaj zgjedhjeje, sipas rregullave me të cilat është më e lidhur.


#### *Neni 27*

Ky statut është hartuar në katër kopje, njëra kopje depozitohet në Zyrën e Noterisë, njëra në Gjykatën e Rrethit Tiranë, njëra në zyrën e tatimeve dhe kopja e fundit mbahet në dokumentat e krijimit të Shoqërisë.

### **ORTAKU I VETËM**

**“GLOBAL PETROLEUM ALBANIA” SH.A**

**Vasileios ARMAOS**  
**Drejtor i Përgjithshëm**

  
*Vasileios Armaos*